



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KONKURRENCËS

NJOFTIM PËR MEDIAT

Autoriteti i Konkurrencës fillon hetimin e thelluar në shërbimin e transportit rrugor qytetas në Tiranë.

Tiranë 21.1.2013 – Komisioni i Konkurrencës ka vendosur hapjen e një hetimi të thelluar për të shqyrtuar nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun e transportit qytetas në Tiranë. Ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës në këtë treg ka filluar pas ankesave të disa operatorëve për shpërndarjen dhe tregtimin e biletave mujore (aboneve).

Hetimi i thelluar do të përqendrohet në tregun e tregimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës. Gjatë hetimit paraprak të zhvilluar në treg nga ana Autoritetit të Konkurrencës, janë vënë re shenja të kufizimit të konkurrencës pasi Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas (SHKTQ) ka refuzuar të shpërndajë kartonat shoqëruar të aboneve sipas sasisë së përcaktuar nga Bashkia e Tiranës. Gjithashtu ndërmarrjet anëtare të kësaj shoqate kanë refuzuar njohjen e aboneve pa këtë karton.

Nga hetimi i AK ka rezultuar se ka shenja kufizimi të konkurrencës edhe për sa i përket tregimit të aboneve për studentët. Në këtë treg ndërmarrjet anëtare të shoqates (SHKTQ), kanë tregtuar një numër më të vogël të aboneve të studentit se sa numri i aboneve të studentit të caktuara nga Bashkia e Tiranës për çdo ndërmarrje.

Kjo sjellje mund të përbëjë kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në treg. Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e tregimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg.

Autoriteti i Konkurrencës gjithashtu ka vendosur marrjen e masës së përkohshme për tregtimin e të gjithë aboneve të studentit nga operatorët që veprojnë në tregun e transportit qytetas sipas sasive të caktuara nga Bashkia e Tiranës. Kjo pasi kufizimi i numrit të aboneve të studentit i shkaktohet një dëm konsumatorëve të këtij shërbimi, (studentëve dhe nxënësve) të cilët janë të detyruar të blejnë bileta apo abone të

përgjithshme me çmime më të larta. Kjo masë e përkohshme do të zbatohet deri në përfundim të hetimit të thelluar të Autoritetit të Konkurrencës. Në rast mos-zbatimi të këtij vendimi apo zbatimit me vonesë të tij, ndërmarrjet rrezikojnë të gjobiten sipas neneve 74 dhe 76 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.